

RREGULLORE

PËR

ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT TË ÇERTIFIKIMIT TË EKSPERTËVE KONTABËL TË RREGJISTRUAR DHE KONTABILISTËVE TË MIRATUAR

Mbështetur në nenin 5, pika 1/a dhe në nenin 17, pika 5 të ligjit Nr.10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, kjo Rregullore miratohet me Vendimin nr.41 datë 09.12.2010 të Bordit të Mbikqyrjes Publike¹.

Neni 1

Objekti i rregullores dhe fusha e veprimit

Kjo rregullore ka për objekt:

1. Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Çertifikimit, që ngrihet e funksionon në zbatim të ligjit 10091 dt. 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.
2. Procedurat e testimit të njohurive të kandidatëve, të cilët kanë përmbushur kërkesat e stazhit profesional, ose kanë fituar të drejtën të testohen për njohuritë teorike e praktike të marra, procedurat e shpalljes së rezultateve të kandidatëve që marrin pjesë në testimin e njohurive për ekspert kontabël të regjistruar dhe kontabilist të miratuar.
3. Dokumentacionin që jepet në përfundim të cdo testi si dhe në përfundim të testeve, respektivisht për Kontabilistët e Miratuar dhe për Ekspertët Kontabël të Regjistruar.

Neni 2

Përkufizimi i termave

Termet e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të ligjit “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”.

Neni 3

Krijimi - Përbërja

¹ dhe me ndryshimet e bera me:

- Vendimin nr.13 datë 17.04.2014 të Bordit të Mbikqyrjes Publike dhe shkresën nr. 6339/1 datë 28.04.2014 të Ministrit të Financave;

- Vendimin nr.9 date 28.07.2015 te BMP dhe shkresen nr. 13886/1 date 05.10.2015 te Ministrit te Financave

1. Autoriteti i Certifikimit është një autoritet i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij, që ngrihet për të zbatuar procedurat e testimit të njohurive dhe të certifikimit të kandidatëve, të cilët kanë përmbushur kërkesat e stazhit profesional ose kanë fituar të drejtën të testohen për njohuritë e tyre teorike dhe praktike, pa pasur nevojë për kryerjen e stazhit profesional.
2. Autoriteti i Certifikimit përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen për një periudhë trevjeçare.
 - Kryetari i Autoritetit të Certifikimit emërohet nga Ministri i Financave.
 - Anëtarët e Autoritetit të Certifikimit emërohen nga Ministri i Financave, sipas propozimeve të mëposhtme:
 - a) një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë;
 - b) një përfaqësues i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit;
 - c) një përfaqësues i organizatës profesionale të ekspertëve kontabël të regjistruar;
 - ç) një përfaqësues nga organizatat profesionale të fushës së kontabilitetit.
3. Anëtarët e Autoritetit të Certifikimit janë individë të diplomuar dhe të specializuar në fushat e ekonomisë dhe/ose të jurisprudencës, të lidhura me auditimin, kontabilitetin e financën, me përvojë jo më të vogël se pesë vjet, si dhe të kenë punuar në institucionin apo/ose të jetë anëtar në organizatën propozuese.
4. Autoriteti i Certifikimit ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me këtë rregullore dhe me aktet ligjore e nënligjore, që përcaktojnë kriteret në veprimtarinë e certifikimit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar.
5. Sekretaria teknike e Autoritetit të Certifikimit realizohet dhe organizohet nga stafi ekzekutiv i Institutit.

Neni 4

Disiplinat e testimit të aftësive profesionale

1. **Për kandidatët ekspert kontabël të regjistruar**, bazuar në nenin 18 të ligjit "10091, datë 5.03.2009...", provimi i aftësisë profesionale përmban të paktën, pesë teste të detyrueshme me shkrim, të cilat mbulojnë këto disiplina:
 - a) kontabilitet, raportim financiar dhe analizë e pasqyrave financiare;
 - b) e drejtë civile, e drejtë penale, legjislacioni tregtar dhe e drejtë e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor të pasqyrave financiare;
 - c) kodi i etikës për profesionistët kontabël, standardet ndërkombëtare të kontrollit të cilësisë, standardet ndërkombëtare të auditimit, direktivat e praktikave ndërkombëtare të auditimit, standardet ndërkombëtare të angazhimeve për të rishikuar, standardet ndërkombëtare të angazhimeve të dhënies së sigurisë dhe standardet për çështje specifike, të publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve dhe të përkthyer, si dhe rregullat e organizimit të profesionit të

- ekspertit kontabël, të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet në zbatim të tij;
- ç) organizimi, drejtimi, administrimi dhe kontrolli i brendshëm i personave juridikë, përfshirë sistemet e informacionit dhe të informatikës;
- d) legjislacioni fiskal në Republikën e Shqipërisë.
2. **Për të fituar titullin kontabilist i miratuar**, kandidatët u nënshtrohen provimit të aftësisë profesionale vetëm për dy disiplinat parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të cituara më sipër.

Neni 5

Mbledhjet e Autoritetit të Çertifikimit

1. Mbledhja e Autoritetit thirret dhe drejtohet nga kryetari. Në mungesë të kryetarit dhe me autorizim të tij, mbledhjet mund të drejtohen nga njëri prej anëtarëve të Autoritetit.
2. Mbledhjet e Autoritetit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se katër anëtarë. Nëse njëri nga anëtarët mungon në tre mbledhje rradhazi të paarsyetuara (përrjashtimisht rastet e shërbimeve jashtë shtetit dhe sëmundjet) propozohet zëvendësimi i tij brenda sezonit. Për ditët e mungesave me dhe pa arsye nuk kryhet pagesë. Vendimet janë të vlefshme, kur votojnë “pro” shumica e anëtarëve pjesëmarrës. Në rast të numrit të barabartë të votave “pro” dhe “kundër”, vota e kryetarit të Autoritetit konsiderohet “më shumë se një votë”. Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Ata duhet të jenë të argumentuar dhe në cdo rast, vendimet “kundër” duhet të shpjegohen në proces verbalin e mbledhjes.
3. Vendimet e Autoritetit përgatiten në tri kopje, të cilat mbahen në sekretarinë teknike, me libra dhe organizim të posacëm për Autoritetin.
4. Mbledhja e Autoritetit konsiderohet e vlefshme kur ka rend dite të përcaktuar, të hartuar nga Kryetari, e cila procedon me vendimarrje për të gjitha çështjet e parashikuara në rendin e ditës. Jashtë sezonit të provimeve mbledhjet e Autoritetit organizohen sipas nevojave, por jo më shpesh se një herë në muaj.
5. Mbledhjet e Autoritetit janë të mbyllura dhe në to mbahet protokoll.
6. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen anëtarëve nga sekretaria, jo më vonë se 5 ditë para ditës së caktuar për mbledhje, me përjashtim të mbledhjeve për realizimin e testit.
7. Autoriteti i Çertifikimit mund të realizojë mbledhjet e tij edhe në ambiente të ndryshme nga të IEKA-s, me kushtin që të sigurohet integriteti i procesit.
8. Procesi i testimeve dhe certifikimit është objekt i mbikqyrjes nga Bordi i Mbikqyrjes Publike, i cili me anën e anëtarëve të tij, të pajisur me autorizim nga kryetari i Bordit, ka të drejtë të jetë prezent gjatë gjithë procesit.

Neni 6

Buxheti dhe tarifat e regjistrimit

1. Kostot e administrimit të veprimtarisë së Autoritetit mbulohen nga tarifat e regjistrimit të kandidatëve që testohen. Tarifat e regjistrimit llogariten nga sekretaria teknike dhe nëpërmjet Autoritetit të Certifikimit, i dërgohen për miratim Bordit të Mbikqyrjes Publike. Tarifat e regjistrimit të arkëtuara, janë të pakthyeshme. Kandidatëve që kanë kryer pagesat dhe për arsye të ndryshme nuk janë paraqitur në testim, pagesa i njihet për sezonin e ardhshëm.
2. Kryetari dhe anëtarët e Autoritetit marrin shpërblim fiks për çdo ditë të pjesëmarrjes. Masa e shpërblimit miratohet nga bordi, sipas propozimit të Këshillit Drejtues të IEKA-s.
3. Personat që angazhohen si vëzhgues, hartues dhe korigjues testesh si dhe personeli tjetër ndihmës marrin honorare, masa e të cilave miratohet nga Bordi i Mbikqyrjes Publike pas propozimit të Autoritetit.
4. Sekretaria Teknike e AC mban rregjistrime të vecanta të arketimeve dhe pagesave që lidhen me veprimtarinë e Autoritetit të Certifikimit. Në përfundim të procesit të testimit të kandidatëve, Sekretaria teknike i paraqet Autoritetit të Certifikimit një raport financiar ku evidentohen arkëtimet, shpenzimet e kryera për testimin e kandidatëve dhe teprica e mbetur ose diferenca e pambuluar.
5. Mbi bazën e të dhënave që siguron sekretaria teknike, Autoriteti i Certifikimit harton dhe i dërgon për miratim Bordit të Mbikqyrjes Publike një preventiv shpenzimesh për çdo sezon, 2 muaj përpara provimit të parë. Mbas miratimit të këtij preventivi nga Bordi, ngarkohet Autoriteti i Certifikimit të ndjekë zbatimin e tij. Me kërkesën e Autoritetit, në varësi të numurit të kandidatëve të regjistruar, Bordi mund të rishikojë preventivin e miratuar.
6. Pas mbylljes së çdo viti kalendarik, brenda muajit janar të vitit pasardhës, Autoriteti i Certifikimit raporton pranë Bordit për realizimin e Buxhetit të vitit.

Neni 7

Rregjistrimi i kandidatëve për provimet e aftësisë profesionale

1. Autoriteti i Certifikimit shpall periudhën për pranimin e kërkesave për provimet e aftësisë profesionale të kandidatëve si edhe afatet e kryerjes së testeve.
2. Të gjithë personat që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për tu testuar për njohuritë e tyre të fituara.

3. Kërkesat të cilat i adresohen Autoritetit të Certifikimit depozitohen dhe protokollohen në sekretarinë teknike për Autoritetin.
4. Kërkesat duhet të shoqërohen me dokumentacionin që provon se kandidati i përmbush kushtet e parashikuara nga Ligji për të hyrë në provimin përkatës.
5. Autoriteti i Certifikimit publikon të paktën 1 muaj përpara fillimit të regjistrimit të kandidatëve për provime, listën e dokumentave që duhet të paraqesin kandidatët për t'u regjistruar.
6. Autoriteti i Certifikimit shpall listën e kandidatëve dhe përcakton grafikun e zhvillimit të provimeve sipas disiplinave.
7. Sezoni i provimeve zhvillohet një herë në vit në datat e miratuara nga Autoriteti i Certifikimit.
8. Provimet e aftësisë profesionale do të jenë sipas radhës së përshkruar në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të kësaj rregullorjeje.
9. Informacionet në lidhje me regjistrimin, shpalljen e listës, të afateve dhe për çështje të tjera që lidhen me testimin, publikohen në faqen e internetit të IEKA-s dhe të Ministrisë së Financave. Programet e lëndëve dhe literatura bazë publikohen në faqen e internetit të Institutit, 6 muaj përpara datës së provimeve. Para publikimit të programeve të lëndëve dhe të literaturës, IEKA, merr zyrtarisht propozimet nga organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar. Subjektet e autorizuara nga Bordi për realizimin e kurseve të kualifikimit në funksion të testeve për Kontabilistë të Miratuar apo Ekspertë Kontabël të Regjistruar, janë të detyruar të respektojnë programet e miratuara dhe shpallura nga IEKA.

Neni 8

Organizimi i testimit të kandidatëve

1. Provimet zhvillohen me shkrim.
2. Autoriteti i Certifikimit përcakton rregullat e zhvillimit të testimit, të cilat duhet të garantojnë kushte të barabarta konkurimi, anonimatit e pjesëmarrësve në provimin me shkrim, rregullin dhe qetësinë në mjediset ku zhvillohet testimi si dhe bën të njohur sistemin e vlerësimit të provimit dhe masat ndaj pjesëmarrësve që veprojnë në kundërshtim me këto rregulla. (aneksi 1- Procedura e organizimit të provimit).

3. Para cdo provimi AC përgatit një kujtesë me shkrim në lidhje me procedurat dhe rregullat e zhvillimit të provimit dhe ua bën të njohur kandidatëve.
4. Para cdo provimi anëtarët e Autoritetit, bëjnë deklaratë për konfliktin e interesit, si aneksi nr.3, bashkëlidhur.

Neni 9

Hartimi i testeve

1. Autoriteti miraton paraprakisht strukturën e tezës së provimit, bazuar në programin për të cilin kerkohet listimi dhe përcaktimi disa seksioneve të pyetjeve (alternative, shtjellim, zgjidhje).
2. Për hartimin e çdo testi Autoriteti cakton ekspertë dhe pedagogë me eksperiencë të fushave përkatëse. Autoriteti harton "Letër angazhimi" e cila nënshkruhet nga hartuesit ku përcaktohen përgjegjësitë e tyre për të përgatitur një fond pyetjesh sipas programit të disiplinës dhe strukturës së miratuar nga Autoriteti për formën dhe përmbajtjen e pyetjeve. Ata duhet të nënshkruajnë edhe një deklaratë për konfliktin e interesit (sipas aneksit nr.3 bashkëlidhur).
3. Për çdo disiplinë totali i fondit të pyetjeve që do të përgatitet nga hartuesit e caktuar nga Autoriteti i Çertifikimit të përmbajë jo më pak se dhjetëfishin e pyetjeve/alternativave/ushtrimeve që duhen për një test, sipas strukturës së miratuar të provimit. Ky fond depozitohet pranë Autoritetit jo më herët se një ditë para testimit. Depozitimi i tyre deri në përcaktimin e testit final bëhet në një vend të sigurt të tipit kasafortë dhe mbyllet të paktën me dy dryna dhe çelësat ndahen midis anëtarëve të Autoritetit me short dhe kryetarit.
4. Çdo anëtar i Autoritetit të Çertifikimit ka të drejtë të propozojë si hartues të paktën 3 ekspertë të fushës ose pedagogë të njohur.
5. Për hartimin e tezës së provimeve, nga numri total i hartuesve të propozuar, përzgjedhja e hartuesve bëhet me konsensusin e të gjithë anëtarëve të Autoritetit, duke ruajtur një ndarje proporcionale për çdo pjesë të programit të miratuar të provimit sipas seksionit të pyetjeve. Në mungesë të konsensusit, përzgjedhja e hartuesve bëhet me short.
6. Për hartimin e tezës së provimit të parë, do të përzgjidhen të paktën shtatë hartues për të përgatitur fondin e pyetjeve sipas përqindjes që zënë pjesët dhe seksionet në programin e miratuar.
7. Për hartimin e tezave në provimet e tjera do të përzgjidhen të paktën 4 hartues për të përgatitur fondet e pyetjeve sipas strukturës së programit përkatës.
8. Zgjedhja e pyetjeve për testin bëhet me short në ditën e provimit për çdo përbërës të disiplinës në proporcion me përqindjen që ato duhet të zenë në testin përfundimtar

duke siguruar një shpërndarje të drejtë të natyrës së pyetjeve sipas strukturës së miratuar.

9. Menjëherë pas zgjedhjes së pyetjeve, hartohet testi dhe bëhet shumëfishimi në ambiente të mbyllura dhe të monitoruara, në aq kopje sa janë kandidatët.
10. Brenda një dite pas përfundimit të testimit, hartuesit e testeve bëjnë zgjidhjen e tezës, e cila publikohet menjëherë në faqen e internetit të IEKA-s dhe të Ministrisë së Financave.

Neni 10

Korrigjimi i testeve

1. Për korrigjimin e testeve caktohen si korrigjues ekspertë të fushës ose pedagogë me eksperiencë, të fushës. Emrat (Përzgjedhja) dhe numri i korrigjuesve përcaktohen nga Autoriteti i Çertifikimit, pas zhvillimit të provimit me shkrim. Një korrigjues nuk mund të kontrollojë një test të plotë. Autoriteti i Çertifikimit përcakton për korrigjuesit pyetjet/ushtrimet që do të korrigjojë secili.

Çdo anëtar i Autoritetit ka të drejtë të propozojë emra të korrigjuesve në mënyrë proporcionale, për të siguruar një numër total të korrigjuesve jo më pak se dyfishi i korrigjuesve që do të zgjidhen përfundimisht. Nga numri total i korrigjuesve të propozuar, përzgjidhen jo më pak se një korrigjues për çdo 40 kandidatë pjesëmarrës në testim. Në qoftë se numri i kandidatëve është më pak se 40 vetë, përgjidhen të paktën dy korrigjues. Përzgjedhja e korrigjuesve bëhet me konsensusin e të gjithë anëtarëve të Autoritetit nga numri gjithsej i korrigjuesve të propozuar. Në mungesë të konsensusit, përzgjedhja e korrigjuesve bëhet me short.

2. Korrigjuesit që angazhohen për korrigjimin e provimeve, para fillimit të punës, depozitojnë pranë sekretarisë së Autoritetit, deklaratë në lidhje me paanshmërinë e vlerësimit të kandidatëve, si aneksi nr. 2, bashkëlidhur.
3. Nuk lejohet pjesëmarrja e personave të njëjtë në procesin e hartimit dhe atë të korrigjimit të të njëjtit provim.
4. Në përfundim të korrigjimit, ata i dorëzojnë Autoritetit të Çertifikimit, të firmosur në çdo faqe, listën numërore (sipas numrit të testeve) me pikët e rezultuara nga korrigjimi.
5. Autoriteti i Certifikimit përpara ç- sekretimit (lidhjes së emrave me testet), do të verifikojë punën e korrigjuesve duke rikontrolluar me korrigjues të tjerë të gjitha testet që nga korrigjimi i parë janë vlerësuar me 40 pikë - 60 pikë.

Zgjedhja e rikorrigjuesve bëhet me të njëjtën procedurë sic përzgjidhen korrigjuesit.

Në rastet e diferencave ndërmjet dy vlerësimeve, Autoriteti i Certifikimit me anëtarët e vet analizon korrigjimet dhe merr vendimin përfundimtar për vlerësimin e testit.

Neni 11

Vlerësimi i kandidateve

Çdonjëri nga këto teste vlerësohet me pikë nga 0 deri në 20. Vlerësimi i domosdoshëm për t'u kualifikuar për çdo test është nga 10 deri në 20 pikë. Çdo vlerësim i tri testeve të para më i ulët se 10 pikë është eliminues, duke ndërprerë vijimin e mëtejshëm të testimit në atë sezon, për ta rifilluar te provimi i radhës, në sezonin e ardhshëm, nëse kushtet dhe programi i provimeve nuk kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme. Në rastet e tjera, kur vlerësimi është më i ulët se 10 pikë, testimi mund të rijepet vetëm sezonin tjetër.

Neni 12

Shpallja e rezultateve dhe e fituesve

1. Rezultati i testimit shpallet jo më shumë se gjashtë ditë kalendarike pas përfundimit të testit.
2. Shpallja bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aneksin nr. 1.
3. Fitues shpallen kandidatët që kanë fituar numrin e nevojshëm të pikëve të përcaktuar në nenin 11 të kësaj rregullorjeje. Fituesit shpallen në internet në listë emërore (pa pikë) por të renditur sipas rendit alfabetik.

Neni 13

Dëshmitë e testimit

1. Për cdo testim (provim) të dhënë kandidati fitues do të pajiset me dëshmi të firmosur nga Kryetari i Autoritetit të Certifikimit.
2. Në dëshmi tregohen dhe pikët e fituara. Cdo dëshmi përgatitet në dy kopje, nga të cilat një i jepet kandidatit dhe tjetra ruhet në dosjen e kandidatit. Formati i dëshmisë miratohet paraprakisht nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.
3. Në përfundim të procesit të testeve, Autoriteti i Certifikimit pajis kandidatin që i ka fituar të gjitha provimet me një dokument zyrtar të emërtuar "CERTIFIKATE", që vërteton marrjen e titullit profesional, (Kontabël i Miratuar" apo Ekspert Kontabël i Regjistruar). Formati i dokumentit miratohet nga Bordi i Mbikqyrjes Publike, me propozimin e Autoritetit të Certifikimit.
4. Dëshmitë e cdo provimi dhe Çertifikata përfundimtare e titullit profesional të fituar (Kontabilist i Miratuar ose Ekspert Kontabël i Regjistruar), janë me numër rendor dhe regjistrohen progresivisht në një regjistër të posaçëm të Autoritetit të Certifikimit.

Neni 14
Çfuqizime

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullorjeje, rregullorja e miratuar me Udhëzimin nr. 6, datë 08.02.2011, “Për miratimin e Rregullores “Per organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Çertifikimit të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistëve të Miratuar”, çfuqizohet.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë, pas miratimit me Vendimin nr.25 date 05.10.2015 të Ministrit të Financave.

ANEKSI 1

PROÇEDURA E ORGANIZIMIT TE TESTIMIT

1. TE PERGJITHSHME

Të gjithë anëtarët e Autoritetit të Certifikimit me testin e sapopërfunduar shkojnë në sallën ku do kryhet testimi.

Ndalohet hyrja e personave të paautorizuar në sallën ku zhvillohet testimi.

Për të marrë pjesë në testim kandidati duhet të paraqesë dokumentin zyrtar të identifikimit. Pasi kandidatët ulen në vendet e caktuara një anëtar i Autoritetit i asistuar nga vëzhguesi i caktuar i sallës ju shpërndan materialet e testimit ku përfshihen stilolapsat, zarfat dhe testi.

Testi i (provimit) do të ketë vulën e Institutit në çdo faqe. Në zarfin e vogël ka brenda një letër ku kandidati do të shkruaj emrin e tij dhe do ta vendosë në të djathtë të tavolinës. Emri nuk do të shkruhet në asnjë nga fletët e testit. Më pas, një person i caktuar për sekretimin, verifikon emrin e kandidatit me dokumentin e identifikimit, mbyll zarfin e vogël dhe e vulos. Në fund të provimit zarfi i vogël së bashku me testin (e provimit) do të futen në një zarf të madh i cili do vulozet në momentin e dorëzimit.

Më pas, në ambjentet e Institutit në prani të anëtarëve të Autoritetit, një përfaqësues i tij hap zarfin e madh të çdo kandidati dhe vendos numrin e zarfit të vogël në zarfin e madh si edhe në faqen e parë të testit.

Të dy zarfat depozitohen në dy vende të ndryshme të IEKA-s dhe mbyllen me të paktën dy dryna secili ku njërin nga celësat e mban Kryetari dhe tjetrin njëri nga anëtarët e Autoritetit.

Në ditën e korrigjimit anëtarët e Autoritetit nxjerrin zarfat e mëdhenj dhe ju japin testet korrigjuesve.

Korrigjimi i provimit me shkrim do të bëhet në një zyrë brenda godinës së IEKA-s. Korrigjuesit nuk lejohet që të marrin me vete testet.

Kur korrigjuesit ndërpresin korrigjimin, dy anëtarët e Autoritetit që mbajnë celësat e vendit të ruajtjes së testeve thirren për të marrë testet në dorëzim.

Në përfundim të korrigjimit, korrigjuesit i dorëzojnë Autoritetit vlerësimet e tyre në pikë sipas numrave të sekretimit. Këto vlerësime përdoren nga Autoriteti për të shpallur rezultatet sipas procedurave të përcaktuara në rregullore.

2. PROCEDURA SPECIFIKE PER VEZHGIMIN E TESTIMIT

Provimi do të mbikqyret nga vëzhgues të pavarur.

Në çdo klasë duhet të ketë një vëzhgues për 30 kandidatë. Çdo anëtar i Autoritetit të Certifikimit ka të drejtë të propozojë vëzhgues në numër të barazvlefshëm ndaj totalit të tyre. Në rastin kur numri i vëzhguesve (monitoruesve) duhet të jetë më i vogël se 5, zgjidhen me short.

Kandidatët nuk duhet të flasin ose të japin e marrin asistencë nga njëri – tjetri apo nga të tjerë gjatë testimit (provimit), për asnjë lloj arsyeje.

Në qoftë se një gjë e tillë ndodh, atëhere vëzhguesi i provimit vendos menjëherë përjashtimin e të dy kandidatëve (marrësit dhe dhënësit të ndihmës) nga salla e provimit duke e bërë provimin e tyre të pavlefshëm.

Në një klasë duhet të ketë jo më shumë se dy vëzhgues (monitorues), të cilët nuk kanë lidhje me disiplinën që testohet. Cdo anëtar i Autoritetit të Certifikimit duhet të propozojë vëzhgues (monitorues) në numër të barazvlefshëm ndaj totalit të tyre.

Në rastin kur numri i vëzhguesve (monitoruesve) duhet të jetë më i vogël se 5, propozohen me short.

Vëzhguesit nuk duhet të jenë anëtarë të organeve drejtuese të IEKA dhe të Shoqatave të kontabilistëve. Ata kanë për detyrë të mbikqyrin për kryerjen e rregullt të provimit.

Ndalohet përdorimi dhe mbajtja e telefonave celularë si dhe e paisjeve të tjera përveç një makine të thjeshtë llogaritëse.

3. PROCEDURA SPECIFIKE PER KANDIDATET

Gjatë provimit, kandidatët nuk lejohen të shënojnë ose lënë emrin apo shenja sado të vogla në fletët e testit apo të zarfave (nënkuptohen shprehje ose citime që e bëjnë fletën e provimit të identifikueshme).

Në rast kur kandidati gjatë përgjigjes kërkon të bëjë një korigjim të një përgjigjeje të dhënë, fjala ose shprehja duhet të futet në kllapa dhe t'i kalohet një vijë sipër sipas këtij modeli: (standardet ndërkombëtare).

Në rast se konstatohen shenja të ndryshme në fletët e testit të provimit, ato do të shpallen të pavlefshme dhe kandidati s'kualifikohet.

4. KOHA E TESTIMIT DHE VLERESIMI

Provimet do të zhvillohen me shkrim brenda një dite duke filluar nga ora 14.00. Provimi do të jetë katër orë.

Vlerësimi bëhet sipas pikëve që janë shënuar në fund të seciles pyetje.

Teza e provimit konvertohet në rezultatin maksimal prej 20 pikësh. Vlerësimi i domosdoshëm për t'u kualifikuar për çdo test është nga 10 deri në 20 pikë. Çdo vlerësim i tri testeve të para më i ulët se 10 pikë është eliminues, duke ndërprerë vijimin e mëtejshëm të testimit në atë sezon, për ta rifilluar te provimi i radhës, në sezonin e ardhshëm, nëse kushtet dhe programi i provimeve nuk kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme.

**DEKLARATE PËR
VLERESIMIN E PAANSHMERISE TE KORRIGJUESVE TE TESTIMIT**

Unë Z/Znj _____ i/e caktuar nga Autoriteti i Certifikimit, korrigjues/e i/e testeve të kandidatëve ekspert kontabël të regjistruar dhe kontabilist të miratuar, pasi u njoha me listën e kandidatëve dhe Vendimin e Autoritetit për caktimin tim si korrigjues,

DEKLAROJ SE :

Nuk kam/kam lidhje të afërta familjare, miqësore apo zyrtare me kandidatët në testim dhe nuk kam/kam pasur presion ose lidhje të tjera që vënë në dyshim paanësinë time.

DEKLARUESI

**DEKLARATE PER KONFLIKTIN E INTERESIT
TE ANETAREVE TE AUTORITETIT TE CERTIFIKIMIT**

Unë Z/Znj _____ anëtar i Autoriteti i Certifikimit, të kandidatëve ekspert kontabël të regjistruar dhe kontabilist të miratuar, pasi u njoha me listën e kandidatëve

DEKLAROJ SE :

Kam/ nuk kam lidhje të afërta familjare, miqësore apo zyrtare me kandidatët në testim dhe kam/nuk kam pasur presion ose lidhje të tjera që vënë në dyshim paanësinë time.

PO kam lidhje të afërta familjare _____

JO nuk kam lidhje të afërta familjare _____

PO kam pasur presion ose lidhje të tjera _____

JO nuk kam pasur presion ose lidhje të tjera _____

DEKLARUESI

**DEKLARATE PER KONFLIKTIN E INTERESIT
TE HARTUESVE TE FONDIT TE PYETJEVE TE AUTORITETIT TE CERTIFIKIMIT**

Unë Z/Znj _____ hartues i fondit te pyetjeve te provimit
“Kontabilitet, raportim financiar dhe analiza e pasqyrave financiare”, të kandidatëve ekspert
kontabël të regjistruar dhe kontabilist të miratuar, pasi u njoha me listën e kandidatëve

DEKLAROJ SE :

Kam/ nuk kam lidhje të afërta familjare, miqësore apo zyrtare me kandidatët në testim dhe
kam/nuk kam pasur presion ose lidhje të tjera që vënë në dyshim paanësinë time.

PO kam lidhje të afërta familjare _____

JO nuk kam lidhje të afërta familjare _____

PO kam pasur presion ose lidhje të tjera _____

JO nuk kam pasur presion ose lidhje të tjera _____

DEKLARUESI